

6.5 KRAHASIMI I REGJISTRIMEVE

Regjistrimet në kujtesën e fragmenteve mund t'i krahasoni.

Procedura

1. Gjeni dhe përzgjidhni regjistrimin, të cilin dëshironi ta krahasoni.
2. Përzgjidhni metodën **Kujtesa e fragmenteve / Krahaso regjistrimin**.

Hapet dritarja **Përzgjedhja e regjistrimit për krahasim** me listën e regjistrimeve, të cilat janë të disponueshme për t'u krahasuar me regjistrimin e përzgjedhur. Në listë është regjistrimi nga kujtesa e fragmenteve e regjistrimeve dhe varianti i regjistrimit të përzgjedhur nga baza lokale ose nga COBIB-i.




Figura 6.5-1: Dritarja Përzgjedhja e regjistrimit për krahasim

3. Klikoni regjistrimin, të cilin dëshironi ta krahasoni me regjistrimin e përzgjedhur dhe më pas klikoni butonin **Në rregull**.

Hapet dritarja **Krahasimi i regjistrimeve**, në të cilën të dy regjistrimet shfaqen në formatin COMARC. Ndryshimet mes tyre janë me ngjyrë të verdhë, ndërsa fushat që ndryshojnë paraqiten të "Ndryshojnë fushat" mbi regjistrimin.

4. Për t'i printuar regjistrimet klikoni butonin **Printo**.
5. Dritaren **Krahasimi i regjistrimeve** e mbyllni duke klikuar në butonin **Mbyll**.




Figura 6.5-2: Dritarja Krahasimi i regjistrimeve